

eppc kërkon një Drejtor shitjesh për klientin e saj, i cili një ndër kompanitë më të mëdha në vend në fushën e tregëtisë me shumicë dhe pakicë.

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM:

Kompania është në kërkim të një kandidati i cili duhet të ketë përvojë në menaxhimin e departamentit të shitjeve.

Kandidati duhet të jetë i formuar si drejtues dhe të ketë aftësi të forta analitike për të analizuar dhe interpretuar performancën e shitjeve, trendin dhe konkurrencën e tregut.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Administrim Biznes, Marketing;
- Diplomë Masteri në Administrim Biznes, përbën avantazh;
- Përvojë mbi 5 vjet në drejtimin e shitjeve dhe menaxhim stafi është domosdoshmëri;
- Përvojë në zhvillimin e planeve dhe strategjive të shitjeve;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, drejtimi, organizimi dhe shitjeje;
- Njohje të shkëlqyer të gjuhës Angleze dhe asaj Italiane;
- Njohuri të avancuara të MS Office;
- Të karakterizohet nga ndershmëria, integriteti dhe korrektësia.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Planifikon, drejton organizon dhe kontrollon aktivitetin e shitjeve;
- Planifikon dhe harton objektivat mujorë dhe planin e veprimit;
- Njohje shumë e mirë dhe studim i tregut dhe konkurrencës;
- Bashkëpunimi me njësitë e tjera të kompanisë;
- Krijimi, zhvillimi dhe ruajtja e marrdhënieve të mira me klientët ekzistues & të rinj;
- Ndërton programe efektive për të motivuar, trajnuar dhe drejtuar grupin e shitjes.

Të dhënat:

Pozicioni:	Drejtor i shitjeve;
Vendndodhja:	Autostradë;
Orari:	48 orë në javë;
Udhëtime pune:	Po, kryesisht brenda vendit;
Pagesa:	Paga në nivel drejtuesi;
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	28 Shkurt 2015.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail-it:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.